

AKTUALITET

Sherri për pronën/ Plagoset një person në Kukës, si është gjendja e tij! EMRI



Lexime

16:39 - 24.04.22 | Gazeta Shqiptare



Një tjetër ngjarje e rëndë ka ndodhur pasditen e së dielës në Shtiqen të Kukësit, ku një person është plagosur me armë zjarri.

Shkak i plagosjes është bërë një çështje pronësie. Aktualisht i plagosuri me emrin Festim Axhami ndodhet në spitalin e Kukësit nën kujdesin e mjekëve, jashtë rrezikut për jetën.

Ndërkohë policia ka shpallur në kërkim autorin me emrin Emeril Murati dhe është në ndjekje të tij.

Njoftimi i policisë

Plagosi me armë zjarri një shtetas dhe u largua, falë reagimit të shpejtë të Policisë, pas disa minutash ndjekjeje, kapet dhe vihet në pranga autori i dyshuar.

Sekuestrohet në cilësinë e provës materiale arma e zjarrit me të cilën autori dyshohet se kreu plagosjen.

Më datë 24.04.2022, rreth orës 15:42, në fshatin Shtiqen, shtetasi E. M., 56 vjeç, pas një konflikti të çastit për motive pronësie, ka plagosur me armë zjarri pistoletë, shtetasin F. A., 46 vjeç, banues në fshatin Shtiqen dhe më pas është larguar me automjet.

Menjëherë, shërbimet e Komisarariatit të Policisë Kukës kanë shkuar në vendngjarje dhe falë reagimit në kohë dhe punës së mirorganizuar, bënë të mundur kapjen e autorit të dyshuar të ngjarjes, shtetasin E. M., 56 vjeç, banues në fshatin Shtiqen.

Policia ka sekuestruar në cilësinë e provës materiale armën e zjarrit tip pistoletë, që dyshohet se ka përdorur autori.

I plagosuri shtetasi F. A., ndodhet në spitalin e Kukësit, jashtë rrezikut për jetën.

Grupi hetimor ndodhet në vendin e ngjarjes dhe nën drejtimin e Prokurorisë, po punon për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes.

SHFAQ KOMENTET (0)

MË TË LEXUARAT NË AKTUALITET

**Balla uron për fitoren e Macron: Europë e bashkuar kundër ekstremizmit dhe së djathtës**

24.04.22 | Gazeta Shqiptare

**Delina Ibrahimaj: S’ka monopol, janë 18 kompani të furnizimit me naftë me shumicë**

24.04.22 | Gazeta Shqiptare

**Asnjë humbje jete nga COVID-19, por rriten infektimet, këto janë shifrat zyrtare**

24.04.22 | Gazeta Shqiptare

**Aksidentohet makina në Devoll! Detajet e para (VIDEO)**

24.04.22 | Gazeta Shqiptare

**Vjen sezoni turistik, fshatrat e Njësisë Shalë në Dukagjin mbeten pa rrugë, vihen re rrëshqitje gurësh, banorët e zonës nuk kalojnë dot**

24.04.22 | Gazeta Shqiptare

SHTYPI I DITËS | GAZETA PDF



LAJMET E MINUTËS SË FUNDIT

**Le Pen humbi zgjedhjet në Francë, çfarë vjen më pas për të?**

24.04.22 | Gazeta Shqiptare

**“Sapo e urova Macron”/ Rama: Shpresoj të vijë në Shqipëri në vizitën e tij të parë**

24.04.22 | Gazeta Shqiptare

**Balla uron për fitoren e Macron: Europë e bashkuar kundër ekstremizmit dhe së djathtës**

24.04.22 | Gazeta Shqiptare

**Delina Ibrahimaj: S’ka monopol, janë 18 kompani të furnizimit me naftë me shumicë**

24.04.22 | Gazeta Shqiptare

**Kaliningradi, qyeti rus në zemër të Europës, rreziku më i madh për Gjermaninë dhe Poloninë**

24.04.22 | Gazeta Shqiptare

Të tjera në AKTUALITET



**Balla uron për fitoren e Macron: Europë e bashkuar kundër ekstremizmit dhe së djathtës**

20:50 - 24.04.22 | Gazeta Shqiptare



**Delina Ibrahimaj: S’ka monopol, janë 18 kompani të furnizimit me naftë me shumicë**

20:37 - 24.04.22 | Gazeta Shqiptare



**Asnjë humbje jete nga COVID-19, por rriten infektimet, këto janë shifrat zyrtare**

19:33 - 24.04.22 | Gazeta Shqiptare



**Aksidentohet makina në Devoll! Detajet e para (VIDEO)**

19:18 - 24.04.22 | Gazeta Shqiptare



**Vjen sezoni turistik, fshatrat e Njësisë Shalë në Dukagjin mbeten pa rrugë, vihen re rrëshqitje gurësh, banorët e zonës nuk kalojnë dot**

19:03 - 24.04.22 | Gazeta Shqiptare



**I riu nga Tirana që ushtron prostitucion, ‘halë në sy’ për komshinjtë: Ai fut burra në shtëpi... (Rrëfimi)**

18:52 - 24.04.22 | Gazeta Shqiptare

GAZETA SHQIPTARE  
www.gazetashqiptare.al

“Gazeta Shqiptare” është gazeta e pavarur më e vjetër në Shqipëri. E themeluar në 1927, publikimi i saj u ndërpre në 1939, me pushtimin fashist të Shqipërisë.

Email: gazetashqiptare.al@gmail.com  
Marketing: marketing@gazetashqiptare.com  
Kontakt: 0684063842  
Financa : 0682074397  
Marketing : 0688087323

Brenda

AKTUALITET  
POLITIKË  
EKONOMI  
Media  
OPINION  
SHËNDET

Tjera

Suplemente  
Horoskopi  
Shtypi i ditës  
Speciale  
20 vite me pare

Focus Press

Kush jemi ne  
Kontakt  
Privacy Policy